

Sektor i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 68 paragrafi (5) nga Rregullorja gjyqësore dhe neni 31 të Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.14/2022 të 20 janarit 2022), duke vepruar sipas Rekomandimeve të Byrosë për përfaqësimin e RMV mbi lëndën (*Dimçevska kundër Maqedonisë së Veriut (Dimcevska v. North Macedonia)*, nr.13919/18, të 4 prillit 2023), për respektimin e të drejtës për gjykim të drejtë nga neni 6 paragrafi (1) të GJEDNJ, në seancën e datës 01.11.2023 nxori:

K O N K L U Z I O N

Rekomandimi i Byrosë për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi lëndën (*Dimçevska kundër Maqedonisë së Veriut (Dimcevska v. North Macedonia)*, nr.13919/18, të 4 prillit 2023), për miratimin e Qëndrimit parimor nga Gjykata Supreme apo Sektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të nxjerrë Konkluzion, në linjë të principeve dhe qëndrimeve të GJEDNJ të shprehura në aktgjykimin në fjalë, me të cilin është konstatuar, shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë nga neni 6 paragrafi (1) nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të dorëzohen në grupin punues për përgatitjen e Ligjit të ri për procedurë penale, me propozim për zgjerimin e kornizës juridike dhe bazat për përsëritjen e procedurës, për respektimin e të drejtës për gjykim të drejtë nga neni 6 paragrafi (1) të GJEDNJ.

A r s y e t i m

Në lidhje me shkresën dhe Rekomandimin e Byrosë për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi lëndën (*Dimçevska kundër Maqedonisë së Veriut (Dimcevska v. North Macedonia)*, nr.13919/18, të 4 prillit 2023), Sektori i veprave penale konsideron se udhëzimet që janë dhënë në rekomandimin janë në kundërshtim me Ligjin për procedurë penale, në mënyrë që nxori Konkluzion që e njëjta të dorëzohet në grupin punues për përgatitjen e Ligjit të ri për procedurë penale.

Kjo, ngase në rrjedhë është prurja e Ligjit të ri për procedurë penale, dhe në këtë mënyrë do të mundësohet përfshirja e rekomandimeve në ligjin, përkatësisht do të zgjerohet korniza juridike dhe bazat për përsëritjen e procedurës.

Në fakt, në këtë mënyrë në të ardhmen do të pengohen shkelje të ngjashme të Konventës, sikur ato veç më të konstatuara nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në aktgjykimin konkret kundër shtetit.

SEKTORI I VEPRAVE PENALE